



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 434/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1950 (njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Me datën 02.11.2013, LVV-ja ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 02.11.2013, në ora 12:00, në Prishtinë, në rrugën UCK te “Qafa”, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) kanë vërejtur se militantët e PDK-së kanë vendosur banerin e kandidatit për kryetar të komunës nga radhët e këtij subjekti politik, mbi rrugë publike dhe po ashtu ky poster është vendosur në këtë datë duke ditur se është heshtje zgjedhore. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimi i tillë është në kundërshtim me nenin 33 pika b e LZP-së, nenin 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013.. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar tri fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 03.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.11.2013 deri në ora 19:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, lidhur me ankesën Anr.434/2013, ku ka theksuar se, pretendimet ankimore të bëra nga LVV-ja janë të pa baza, sepse kemi indicie se rastet e tilla po kryen nga individ që nuk janë anëtarë të PDK-së, duke i vendosur ato në vende të pa lejuara, me qëllim për ta dëmtuar PDK-në. Për më tepër ka shtuar se, nga momenti i njoftimit për rastin në fjalë, menjëherë është intervenuar dhe është hequr baneri i kandidatit nga radhët e subjektit tonë politik.

Në përgjigje në ankesë e ka bashkangjitur provën si në vijim :  
Një fotografi që dëshmon largimn e banerit

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## **ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se, si baneri i subjektit politik PDK është vendosur në të dy anët mbi rrugën publike, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik PDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika b) të LZP-së, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e posterëve mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik PDK, përveq thënieve se veprimet e tilla janë kryer nga individ që nuk janë anëtarë të PDK-së, me pretendimin se vendosja e posterit është bërë nga individ apo qytetarë të pa njohur. Për më tepër, në mes tjerash theksohet se, si dëshmi është bashkangjitur fotografia në të cilën dëshmohet largimi i posterit, mirëpo për rastin në fjalë nuk është ofruar asnjë dëshmi që kanë ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar prandaj një pretendim i tillë për tu dëshmuar është i përgjithshëm dhe i paqartë, ashtu siç kërkohet nga dispozitat e nenit 32.6 të LZP-së.

PZAP-i, konstatoi se subjekti politik PDK ka rënë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase e ka vendosur banerin e tyre mbi rrugët publike, shkelje për të cilën është i paraparë dënimi me gjobë, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 434/2013 më datën 04.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Nehat Idrizi**

#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

